


Tregtia e jashtme e mallrave

Shtator 2021

Tiranë, më 18 Tetor 2021: Në Shtator 2021 eksportet e mallrave arritën vlerën 33 mld lekë, duke u rritur me 31,1 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe me 39,4 %, në krahasim me Gusht 2021. Importet e mallrave arritën vlerën 69 mld lekë, duke u rritur me 31,6 %, në krahasim me një vit më parë dhe me 13,4 %, në krahasim me Gusht 2021. Defiçiti tregtar i këtij muaji është 36 mld lekë, duke u rritur me 32,0 %, krahasuar me Shtator 2020 dhe duke u ulur me 3,3 %, në krahasim me Gusht 2021.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Në këtë nëntëmujor eksportet e mallrave arritën vlerën 266 mld lekë, duke u rritur me 36,5 %, ndërkohë importet e mallrave arritën vlerën 556 mld lekë, duke u rritur me 29,6 %, krahasuar me një vit më parë. Defiçiti tregtar arriti vlerën 290 mld lekë, duke u rritur me 23,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2020.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Gjatë muajit Shtator 2021, në rritjen e eksporteve prej 31,1 %, pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me +15,1 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +10,6 pikë përqindje dhe “Ushqime, pije, duhan” me +2,2 pikë përqindje.

Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Shtator 2021




Eksportet, gjatë këtij nëntëmujori janë rritur me 36,5 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të eksporteve, janë: “Materiale ndërtimi dhe metale” me +14,3 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +11,6 pikë përqindje dhe “Tekstile dhe këpucë” me +3,5 pikë përqindje.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Gjatë muajit Shtator 2021, në rritjen e importeve prej 31,6 %, krahasuar me Shtator 2020, kanë ndikuar pozitivisht grupet: “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +12,9 pikë përqindje, “Ushqime, pije, duhan” me +5,0 pikë përqindje , “Materiale ndërtimi dhe metale” me +4,1 pikë përqindje.

Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Shtator 2021



Si nëntëmujor, importet janë rritur me 29,6 %, krahasuar me nëntëmujorin e parë 2020. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve, janë: “Makineri, paisje dhe pjesë këmbimi” me +7,8 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +4,7 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +4,6 pikë përqindje.

Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere


Në muajin Shtator 2021, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Shtator 2020 janë: Itali (19,7 %), Kosova (36,4%) dhe Spanja (74,0 %).

Gjatë këtij nëntëmujori vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (24,2 %), Kosova (52,4 %) dhe Spanja (39,6 %). Ndërsa vendet me të cilët eksportet kanë pasur uljen më të madhe, është: Ukraina (22,0 %) dhe Rusia (38,1 %).

Në muajin Shtator 2021, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Shtator 2020 janë: Italia (18,7 %), Turqia (24,8 %) dhe Greqia (27,5 %). Ndërsa vendi me të cilin importet kanë pasur uljen më të madhe është: Ukraina (52,9 %).

Gjatë këtij nëntëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (29,8 %), Turqia (45,3 %) dhe Kina (25,8 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Zvicra (3,4), Ukraina (20,2 %) dhe Rusia (2,7 %).

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Shtator 2021



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 59,2 %, të gjithë tregtisë. Në Shtator 2021, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 73,0 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 52,5 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (29,2 %), Greqia (8,3 %), Turqi (6,5 %) dhe Kina (6,4 %).

Shkëmbimet tregtare, për nëntëmujorin 2021, me vendet e BE-së zënë 60,5 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Shtator 2021, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 72,0 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 55,0 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (30,2 %), Turqia (7,8 %), Greqia (7,1 %) dhe Gjermania (6,7 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave, Shtator 2021

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2019		299	-3,8	649	1,2	-350	46,0
2020		272	-9,0	605	-6,8	-333	44,9
2018	09 - 18	26	8,9	51	-4,4	-25	51,4
	Janar– Shtator 18	232	15,3	467	3,1	-236	49,6
2019	09 - 19	25	-4,9	52	2,3	-27	47,8
	Janar– Shtator 19	225	-2,8	481	3,1	-256	46,8
2020	09 - 20	25	1,3	52	0,5	-27	48,2
	Janar – Shtator 20	195	-13,5	429	-10,9	-234	45,4
2021	09 - 21	33	31,1	69	31,6	-36	48,0
	Janar– Shtator 21	266	36,5	556	29,6	-290	47,8

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë), Shtator 2021

	Eksporte				Importe			
	Shtator 2020	Shtator 2021	Janar-Shtator 2020	Janar-Shtator 2021	Shtator 2020	Shtator 2021	Janar-Shtator 2020	Janar-Shtator 2021
Vendet e BE-së	19.176	24.181	146.523	191.228	30.061	36.246	246.192	305.811
Austri	170	254	1.113	1.849	469	563	4.044	4.996
Gjermani	1.087	1.733	11.745	14.532	3.893	4.267	32.512	40.422
Greqi	1.368	2.279	9.300	15.499	4.870	6.209	38.690	42.766
Itali	11.766	14.089	89.250	110.880	13.216	15.692	105.360	136.735
Spanjë	1.478	2.572	12.561	17.533	731	903	6.928	8.232
Kroaci	108	168	1.175	1.989	493	671	4.785	5.741
Të tjera të BE-së	3.200	3.087	21.377	28.946	6.389	7.941	53.872	66.918
Mbretëri e Bashkuar	63	111	534	617	343	443	3.687	4.491
Kinë	190	1.009	3.390	6.296	4.745	5.480	37.864	47.651
Kosovë	2.746	3.747	17.937	27.336	751	1.668	5.883	9.316
Maqedonia e Veriut	906	1.145	6.197	9.196	836	1.606	6.529	8.430
Rusi	0	-	13	8	1.009	1.550	10.913	10.621
SHBA	292	307	2.289	3.297	643	1.159	6.567	12.032
Turqi	236	281	1.905	4.235	5.115	6.384	41.143	59.785
Ukrainë	13	31	325	253	379	178	3.228	2.576
Zvicër	33	293	551	1.963	511	2.053	7.532	7.273
Të tjera	1.614	2.017	14.952	21.169	8.050	12.237	59.220	87.659
Gjithsej	25.269	33.121	194.615	265.600	52.443	69.004	428.756	555.646

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë), Shtator 2021

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Shtator 2020	Shtator 2021	Janar-Shtator 2020	Janar-Shtator 2021	Shtator 2020	Shtator 2021	Janar-Shtator 2020	Janar-Shtator 2021
Gjithsej	25.269	33.121	194.615	265.600	52.443	69.004	428.756	555.647
Ushqime, pije, duhan	2.924	3.487	27.537	31.725	8.965	11.601	81.986	94.117
Minerale, lëndë djegëse, en,el,	3.545	6.212	28.370	50.973	4.954	11.730	38.663	58.506
Produkte kimike dhe plastike	714	967	5.488	7.551	7.455	9.141	65.042	82.164
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	103	207	1.424	1.789	1.104	1.322	9.185	10.613
Prodhime druri dhe letre	784	976	6.113	6.705	2.261	2.630	17.349	20.006
Tekstile dhe këpucë	9.579	9.852	75.207	81.955	6.985	8.388	52.255	64.080
Materiale ndërtimi dhe metale	4.247	8.059	28.466	56.354	6.723	8.869	57.234	77.463
Makinëri, pajisje dhe pj, këmb,	2.495	2.521	15.829	20.815	11.882	13.088	90.557	123.791
Të tjera	878	840	6.181	7.735	2.114	2.234	16.486	24.907

Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Shtator 2021

	Itali		Kosovë		Spanjë		Greqi	
	2020	2021	2020	2021	2020	2021	2020	2021
Gjithsej	89.250	110.880	17.937	27.336	12.561	17.533	9.300	15.499
Ushqim, pije duhan	6.466	7.969	2.804	3.368	937	1.131	2.263	2.757
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	890	1.318	3.034	6.358	10.724	15.730	690	5.332
Produkte kimike dhe plastike	1.469	2.150	1.605	2.289	84	19	425	557
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	1.235	1.307	5	14	71	2	10	10
Prodhime druri dhe letre	3.666	4.359	558	666	3	64	990	1.013
Tekstile dhe këpucë	56.702	64.266	82	130	590	401	3.726	3.675
Materiale ndërtimi dhe metale	8.803	15.622	8.141	12.287	106	170	892	1.688
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	7.488	10.329	550	1.124	26	12	40	69
Të tjera	2.532	3.561	1.160	1.100	20	4	264	399

Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Shtator 2021

	Itali		Turqi		Kinë		Greqi	
	2020	2021	2020	2021	2020	2021	2020	2021
Gjithsej	105.360	136.735	41.143	59.785	37.864	47.651	38.690	42.766
Ushqim, pije duhan	14.418	17.685	3.987	5.055	584	749	12.009	12.247
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	4.116	8.349	2.954	3.949	6	10	6.892	6.941
Produkte kimike dhe plastike	13.701	17.059	6.206	7.964	4.080	6.825	5.649	6.810
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	7.378	8.609	202	316	427	538	25	26
Prodhime druri dhe letre	4.239	4.569	2.129	2.504	613	537	2.638	2.979
Tekstile dhe këpucë	23.123	30.012	11.036	13.533	6.977	8.462	2.677	2.416
Materiale ndërtimi dhe metale	12.342	17.637	7.359	15.143	4.761	4.036	5.679	7.490
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	22.571	27.924	5.578	7.766	16.687	21.964	2.097	2.499
Të tjera	3.472	4.891	1.691	3.556	3.729	4.530	1.025	1.358

Metodologjia

Tregtia e Jashtme e mallrave është një publikim periodik mujor që paraqet tregtinë e mallrave të Shqipërisë me vendet e tjera të botës, Të dhënat e përpunuara nga INSTAT për këtë publikim janë të dhëna administrative të cilat merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Definicionet:

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv ose të riekportuar pas përpunimit aktiv,

Vlera F,O,B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues,

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejitimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor,

Vlera C,I,F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat,

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore,

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci,

Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri